

**V E N D I M**  
**Nr.225, datë 19.5.1993**

**PËR TARIFAT E REGJISTRIMIT DHE PAGESAT E VERIFIKIMIT TË KALIBRIMIT  
FILLESTAR OSE PERIODIK TË MJETEVE MATËSE**

Në mbështetje të ligjit nr.7625, datë 20.10.1992 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)", neni 16, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Tarifat e regjistrimit dhe pagesat e verifikimit e të kalibrimit fillestar a periodik të mjeteve matëse paguhet nga pronari ose administruesi i mjeteve matëse.

2. Për regjistrimin e mjeteve matëse miratohen tarifat e përcaktuara në pasqyrën nr.1, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

3. Për verifikimin e kalibrimit fillestar ose periodik të mjeteve matëse miratohen pagesat e përcaktuara në pasqyrën nr.2 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Pagesat e verifikimit a të kalibrimit fillestar ose periodik llogariten për copë, për çdo pronar ose administrues veçan, si dhe për mjete matëse të të njëjtit tip e që verifikohen a kalibrohen në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë.

Kur sasia e mjeteve matëse të të njëjtit tip që do të verifikohen a kalibrohen është më e madhe se një copë, pagesa llogaritet nga produkti i pagesës përkatëse për copë me numrin e copëve të këtij tipi mjeti matës.

Kur puna verifikuese a kalibruuese ndërpritet për shkak të pronarit a të administruesit, pagesa për copë llogaritet mbi bazën e numrit të mjeteve matëse që janë verifikuar a kalibruar faktikisht nga ai tip.

4. Për rastet kur kërkohet kryerja e menjëhershme e verifikimit a kalibrimit të mjeteve matëse dhe bihet dakord për kohën e kryerjes, paguhet dyfishi i pagesës përkatëse të përcaktuar në pasqyrën nr.2, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

5. Për rastet kur kërkohet kryerja e verifikimit a kalibrimit të paplanifikuar, për t'u futur në grafik dhe për të kryer verifikimin a kalibrimin e mjeteve matëse, paguhet 1,5 fishi i pagesës përkatëse të përcaktuar në pasqyrën nr.2, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

6. Pronari ose administruesi, për verifikimin a kalibrimin e mjeteve matëse, përballon edhe shpenzimet shtesë të mëposhtme:

a) Për peshoret hekurudhore, automobilistike dhe ato me platformë:

- lëvizjen e bazës verifikuese;

- fuqinë punëtore ndihmëse.

b) Për vagonçisternat, autobotet dhe rezervuarët:

- materialet e nevojshme ndihmëse;

- pagesën për shfrytëzimin e peshores së përdorur për verifikim.

7. Për rastet kur pronari a administruesi ka rënë dakord me Drejtorinë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit ose me degët e saj në rrethe për vendin dhe kohën e kryerjes së verifikimit a të kalibrimit dhe puna nuk mund të fillojë, nuk mund të vazhdojë ose fillon me vonesë, pasi pronari ose administruesi nuk i ka realizuar a i ka realizuar të mangëta detyrimet e tij për përgatitjen paraprake, paguhet pagesa sipas pasqyrës nr.3 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

8. Kur pronari ose administruesi njofton për moszbatimin e planifikimit të verifikimit a kalibrimit të mjeteve matëse, ndërkohë që Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit ose degët e saj në rrethe kanë filluar punë përgatitore për kryerjen e verifikimit a të kalibrimit, paguhet pagesa sipas pasqyrës nr.3 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

9. Kur gjatë verifikimit a kalibrimit mjeti matës nuk i përgjigjet udhëzimeve të Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit, ai nuk vuloset dhe paguhet gjysma e pagesës përkatëse.

10. Kur mjetet matëse të dërguara në Drejtorinë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit ose në degët e saj në rrethe për verifikim a kalibrim nuk tërhiqen nga prurësi brenda afateve të caktuara nga Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit, paguhet për magazinim një shtesë 2 për qind për çdo mjet matës, për çdo ditë, të pagesës përkatëse të verifikimit a kalibrimit.

11. Tarifat e regjistrimit dhe pagesat e verifikimit a të kalibrimit derdhen në bankë në numrin e llogarisë së Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit, i paguhen me çek ose me para në dorë punonjësit që kryejnë regjistrimin, verifikimin a kalibrimin e mjetit matës përkundrejt mandatarkëtimit përkatës të lëshuar prej tij.

12. Dispozitat dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

Pasqyra 1

#### Tarifat e regjistrimit të mjeteve matëse

| Emërtimi                                                    | Lekë                    |               |
|-------------------------------------------------------------|-------------------------|---------------|
| 1. Regjistrimi                                              |                         |               |
| - për çdo mjet matës .....                                  | 300                     | 300           |
| - për gramarë ose masa vëllimore seri, deri në 5 copë ..... |                         |               |
| - për çdo gramar ose masë vëllimore shtesë .....            | 50                      |               |
|                                                             |                         |               |
| Verifikim vëllimi                                           | Numri i enëve<br>(copë) | Lekë për copë |
| mbi 1dm <sup>3</sup> deri 5 dm <sup>3</sup> .....           | deri 5 .....            | 300           |
|                                                             | 6 deri 20 .....         | 270           |
|                                                             | 21 deri 100 .....       | 230           |
|                                                             | mbi 100 .....           | 200           |
| mbi 5dm <sup>3</sup> deri 10dm <sup>3</sup> .....           | deri 5 .....            | 400           |
|                                                             | 6 deri 20 .....         | 350           |
|                                                             | 21 deri 100 .....       | 300           |
|                                                             | mbi 100 .....           | 270           |
| mbi 10dm <sup>3</sup> deri 20dm <sup>3</sup> .....          | deri 5 .....            | 600           |
|                                                             | 6 deri 20 .....         | 450           |
|                                                             | 21 deri 100 .....       | 400           |
|                                                             | mbi 100 .....           | 350           |
| mbi 20dm <sup>3</sup> deri 50dm <sup>3</sup> .....          | deri 5 .....            | 800           |
|                                                             | 6 deri 20 .....         | 500           |
|                                                             | 21 deri 100 .....       | 450           |
|                                                             | mbi 100 .....           | 400           |
| mbi 50dm <sup>3</sup> deri 100dm <sup>3</sup> .....         | deri 5 .....            | 1000          |

|                   |     |
|-------------------|-----|
| 6 deri 20 .....   | 600 |
| 21 deri 100 ..... | 500 |
| mbi 100 .....     | 450 |

Gjatë procesit të kalibrimit, për çdo nëndarje që bëhet në enët vëllimore të pikës 3, paguhet një shtesë sa gjysma e pagesës përkatëse për verifikimin e vëllimit të plotë.

4. Masa vëllimore për lëngje, në të cilat kufiri i vëllimit do të përcaktohet nga verifikimi. Në këtë rast pagesa përfshin vizimin dhe tregimin e vëllimit (bëjnë përjashtim pikat 5 dhe 6).

| Verifikim vëllimi                                 | Numri i enëve     | Lekë për copë (copë) |
|---------------------------------------------------|-------------------|----------------------|
| deri 1dm <sup>3</sup> .....                       | deri 5 .....      | 400                  |
|                                                   | 6 deri 20 .....   | 300                  |
|                                                   | 21 deri 100 ..... | 250                  |
|                                                   | mbi 100 .....     | 200                  |
| mbi 1dm <sup>3</sup> deri 5dm <sup>3</sup> .....  | deri 5 .....      | 500                  |
|                                                   | 6 deri 20 .....   | 400                  |
|                                                   | 21 deri 100 ..... | 350                  |
|                                                   | mbi 100 .....     | 300                  |
| mbi 5dm <sup>3</sup> deri 10dm <sup>3</sup> ..... | deri 5 .....      | 600                  |
|                                                   | 6 deri 20 .....   | 500                  |
|                                                   | 21 deri 100 ..... | 450                  |

| Verifikim vëllimi                                   | Numri i enëve<br>(copë) | Lekë për copë |
|-----------------------------------------------------|-------------------------|---------------|
|                                                     | mbi 100 .....           | 400           |
| mbi 10dm <sup>3</sup> deri 20dm <sup>3</sup> .....  | deri 5 .....            | 800           |
|                                                     | 6 deri 20 .....         | 600           |
|                                                     | 21 deri 100 .....       | 500           |
|                                                     | mbi 100 .....           | 450           |
| mbi 20dm <sup>3</sup> deri 50dm <sup>3</sup> .....  | deri 5 .....            | 1000          |
|                                                     | 6 deri 20 .....         | 700           |
|                                                     | 21 deri 100 .....       | 600           |
|                                                     | mbi 100 .....           | 500           |
| mbi 50dm <sup>3</sup> deri 100dm <sup>3</sup> ..... | deri 5 .....            | 1200          |
|                                                     | 6 deri 20 .....         | 800           |
|                                                     | 21 deri 100 .....       | 700           |
|                                                     | mbi 100 .....           | 600           |

Gjatë procesit të kalibrimit, për çdo nëndarje që bëhet në enët vëllimore të pikës 4, paguhet një shtesë sa gjysma e pagesës përkatëse për verifikimin e vëllimit të plotë.

5. Masa qelqi dhe porcelani me vëllim deri 5 dm<sup>3</sup>.

Pagesa për verifikimin dhe vendosje të shenjës në enët e qelqit a të porcelanit (gota, krikëlla, kana, shishe etj.) është si më poshtë:

| Verifikim vëllimi           | Numri i enëve<br>(copë) | Lekë për copë |
|-----------------------------|-------------------------|---------------|
| deri 1dm <sup>3</sup> ..... | deri 5 .....            | 200           |

|                                                  |                   |     |     |
|--------------------------------------------------|-------------------|-----|-----|
|                                                  | 6 deri 20 .....   | 150 |     |
|                                                  | 21 deri 100 ..... |     | 120 |
|                                                  | mbi 100 .....     | 100 |     |
| mbi 1dm <sup>3</sup> deri 5dm <sup>3</sup> ..... | deri 5 .....      | 250 |     |
|                                                  | 6 deri 20 .....   |     | 200 |
|                                                  | 21 deri 100 ..... |     | 170 |
|                                                  | mbi 100 .....     |     | 150 |

Për masa prej qelqi me ngjyrë ose pa ngjyrë, por të tejdukshme, vlejné pagesat e vendosura në pikën 5.

Për masa prej qelqi jo të tejdukshme dhe porcelani, pagesa e verifikimit të tyre është sa dyfishi i atyre të vendosura në pikën 5.

6. Voza, damixhane, shishe me vëllim mbi 5dm<sup>3</sup>, rezervuarë, bote, autobote, vagonçisterna.

6/1 Voza, damixhane, shishe, rezervuarë.

| Verifikim vëllimi                                       | Lekë për copë |
|---------------------------------------------------------|---------------|
| deri 50dm <sup>3</sup> .....                            | 500           |
| mbi 50 dm <sup>3</sup> deri 100 dm <sup>3</sup> .....   | 600           |
| mbi 100 dm <sup>3</sup> deri 200 dm <sup>3</sup> .....  | 800           |
| mbi 200 dm <sup>3</sup> deri 300 dm <sup>3</sup> .....  | 1000          |
| mbi 300 dm <sup>3</sup> deri 400 dm <sup>3</sup> .....  | 1200          |
| mbi 400 dm <sup>3</sup> deri 500 dm <sup>3</sup> .....  | 1400          |
| mbi 500 dm <sup>3</sup> deri 600 dm <sup>3</sup> .....  | 1600          |
| mbi 600 dm <sup>3</sup> deri 700 dm <sup>3</sup> .....  | 1800          |
| mbi 700 dm <sup>3</sup> deri 800 dm <sup>3</sup> .....  | 2000          |
| mbi 800 dm <sup>3</sup> deri 900 dm <sup>3</sup> .....  | 2200          |
| mbi 900 dm <sup>3</sup> deri 1000 dm <sup>3</sup> ..... | 2500          |

Për verifikimin e vozave prej druri, nëse janë të nevojshme punët plotësuese (fshirja e shënimeve të mëparshme etj.), pagesa rritet me 25 për qind e pagesës përkatëse të pikës 6/1.

6/2 Kur verifikimi i enëve vëllimore të pikës 6/1 bëhet në vendpërdorim (birrari, punishte, etj.) dhe pronari ose administratori vë në dispozicion pajisjet e nevojshme e kryen punët ndihmëse, pagesa ulet me 50 për qind të pagesës përkatëse të vendosur në pikën 6/1.

#### 6/3 Autobote

| Verifikim vëllimi                                          | Lekë për copë |
|------------------------------------------------------------|---------------|
| deri 5000 dm <sup>3</sup> .....                            | 3500          |
| mbi 5000 dm <sup>3</sup> deri 10000 dm <sup>3</sup> .....  | 4000          |
| mbi 10000 dm <sup>3</sup> deri 15000 dm <sup>3</sup> ..... | 4500          |
| mbi 15000 dm <sup>3</sup> deri 20000 dm <sup>3</sup> ..... | 5000          |
| mbi 20000 dm <sup>3</sup> deri 25000 dm <sup>3</sup> ..... | 5500          |
| mbi 25000 dm <sup>3</sup> deri 30000 dm <sup>3</sup> ..... | 6000          |
| mbi 30000 dm <sup>3</sup> .....                            | 6500          |

#### 6/4 Vagonçisterna

| Verifikim vëllimi                | Lekë për copë |
|----------------------------------|---------------|
| deri 25000 dm <sup>3</sup> ..... | 8000          |
| mbi 25000 dm <sup>3</sup> .....  | 10000         |

6/5 Për verifikimin e enëve vëllimore, autoboteve, autoçisternave me shumë nëndarje (gryka mbushjeje) të veçanta, të ndara nga njeratjetra, kur verifikimi i nëndarjeve bëhet në të njëjtën kohë, për çdo nëndarje (grykë mbushjeje) paguhet 50 për qind e pagesës së verifikimit të vëllimit përkatës të dhënë në pikat 6/1, 6/3 e 6/4.

6.6 Gjatë procesit të kalibrimit, për çdo nëndarje që bëhet në enët vëllimore, autobotet, autoçisternat etj. të pikës 6, paguhet një shtesë sa gjysma e pagesës përkatëse për verifikimin e vëllimit të plotë.

#### 7. Aparate të shpërndarjes së karburanteve

| Verifikim vëllimi  | Lekë për copë |
|--------------------|---------------|
| distributorë ..... | 4000          |

#### 8. Gramarë

##### 8/1 Klasa $M_3$

|                  |     |
|------------------|-----|
| deri 500 g ..... | 50  |
| 1 kg, 2 kg ..... | 70  |
| 5 kg .....       | 90  |
| 10 kg .....      | 120 |
| 20 kg .....      | 150 |
| 50 kg .....      | 200 |

##### 9/2 Klasat $M_1$ dhe $M_2$

Për verifikimin e gramarëve të klasave  $M_1$  dhe  $M_2$  bëhet dyfishi i pagesës përkatëse të dhëna në 9/1.

9/3 Për punime kalibrimi (shtim ose pakësim materiali në vrimën e gramarit), pastrime, heqje vule etj., paguhet një shtesë 80 për qind mbi pagesat përkatëse të pikave 9/1 dhe 9/2.

| 10. Peshore                               | Lekë për copë |
|-------------------------------------------|---------------|
| 10/1 Peshore analitike dhe saktësie ..... | 2500          |
| 10/2 Peshore me fushë të shkallëzuar      |               |
| deri 1 kg .....                           | 600           |
| mbi 1 kg deri 10 kg .....                 | 800           |
| mbi 10 kg deri 100 kg .....               | 1000          |
| mbi 100 kg .....                          | 1200          |

##### 10/3 Peshore me krahë të barabartë

|                            |      |
|----------------------------|------|
| deri 1 kg .....            | 500  |
| mbi 1 kg deri 10 kg .....  | 700  |
| mbi 10 kg deri 50 kg ..... | 1000 |

##### 10/4 Peshore me platformë

|                                |      |
|--------------------------------|------|
| deri 250 kg .....              | 1500 |
| mbi 250 kg deri 500 kg .....   | 1700 |
| mbi 500 kg deri 1000 kg .....  | 2000 |
| mbi 1000 kg deri 2000 kg ..... | 500  |
| mbi 2000 kg deri 5000 kg ..... | 3000 |

|                                 |       |
|---------------------------------|-------|
| mbi 5000 kg deri 10000 kg ..... | 3500  |
| mbi 10 t deri 20 t .....        | 4500  |
| mbi 20 t deri 30 t .....        | 6000  |
| mbi 30 t deri 50 t .....        | 8000  |
| mbi 50 t deri 120 t .....       | 10000 |
| mbi 120 t .....                 | 12000 |

#### 10/5 Kandarë me bisht

|                             |      |     |
|-----------------------------|------|-----|
| deri 5 kg .....             | 300  |     |
| mbi 5 kg deri 25 kg .....   |      | 500 |
| mbi 25 kg deri 100 kg ..... | 800  |     |
| mbi 100 kg .....            | 1000 |     |

Pasqyra 3

#### Mosplotësime të detyrimeve

| E m ë r t i m i | Pagesa |
|-----------------|--------|
|-----------------|--------|

#### 1. Puna për verifikimin ose kalibrimin e mjetit matës:

- nuk mund të fillojë ose ndërpritet ..... 25% të pagesës përkatës
- fillon me vonesë dhe për çdo orë pune të vonuar ..... 250 lekë për orë për person

#### 2. Moszbatimi i një shërbimi të planifikuar:

- kur puna përgatitore nuk ka filluar ..... 5% të pagesës përkatëse
- kur puna përgatitore ka filluar ..... 10% të pagesës përkatëse
- kur puna përgatitore ka mbaruar ..... 15% të pagesës përkatëse